



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 168 Prot.

Tiranë, më datë 27.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 120, datë 27.03.2026**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.03.2026:

**VENDOSI**

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “*Godinë shërbimi, zyra dhe edukimi, faza 2, me 6, 7, 10, 11 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë*”, me vendndodhje Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjekti “**Fusha**” sh.p.k.;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për “*Godinë shërbimi, zyra dhe edukimi, faza 2, me 6, 7, 10, 11 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë*”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Endri HAXHIU**

**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**